

VENDIM
Nr.812, datë 4.6.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
BASHKIA VLORË, TË QARKUT TË VLORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, bashkia Vlorë, të qarkut të Vlorës, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 13 (trembëdhjetë), dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

2.FORMULAR PER TRANSFERIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Mbështetur në inventarizimin e pronave të veçanta të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: MMPAU										
Bashkia: Vlorë										
Fusha e përdorimit të pronës: pyll										
Nr.	Nr i inv	Emërtesa e ekonomisë pyjore/kullosore	Emërtesa e ngastrës vendndodhja (sipas emërimit popullor)	Numri i ngastrës	Destinacioni	Sipërfaqja në ha.	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësi administrative	Institucioni, enti përdorues, statusi juridik	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	595	Ek. Pyj. Kume-Shashicë	Per karshi hekurudhes	16/a	Pyll	3	Pyll mbrojtje	MMPAU	D.SH.P. Vlorë	
2	596	"	Shengjin deri te pishat e buta	16/b	Pyll	4.3	Pyll mbrojtje	MMPAU	D.SH.P. Vlorë	
3	597	"	Plep kanadez	16/c	Pyll	2.5	Pyll mbrojtje	MMPAU	D.SH.P. Vlorë	
4	598	"	Pisha e bute	16/d	Pyll	6.5	Pyll mbrojtje	MMPAU	D.SH.P. Vlorë	
5	600	"	Plepi i bajramit	17/a	Pyll	24	Pyll mbrojtje	MMPAU	D.SH.P. Vlorë	
6	601	"	Plepi bajramit zyra	17/b	Pyll	13.5	Pyll mbrojtje	MMPAU	D.SH.P. Vlorë	
7	606	"	Kampi pionereve D.Sh. P	19/a	Pyll	2.5	Pyll mbrojtje	MMPAU	D.SH.P. Vlorë	
8	607	"	Zyrat pyjores plazh	19/b	Pyll	17	Pyll mbrojtje	MMPAU	D.SH.P. Vlorë	
9	608	"	Kampi i pionereve plazh	19/c	Pyll	6.5	Pyll mbrojtje	MMPAU	D.SH.P. Vlorë	
10	609	"	Qafa e rapit fabrika e tullave	20/a	Pyll	7.5	Pyll mbrojtje	MMPAU	D.SH.P. Vlorë	
11	610	"	Lapidari 1920	20/b	Pyll	2	Pyll mbrojtje	MMPAU	D.SH.P. Vlorë	
12	611	"	Perroi Jonufer	33/a	Pyll	25.5	Pyll mbrojtje	MMPAU	D.SH.P. Vlorë	
13	612	"	Mbi perruan Jonufres	33/b	Pyll	4.5	Pyll mbrojtje	MMPAU	D.SH.P. Vlorë	

Njësia e qeverisjes vendore: bashkia Vlorë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
595-598, 600-601, 606-612	Pyll, kullotë etj.	Në pronësi